

Albanska

Faktablad för arbetssökande –
Stöd och matchning – mer stöd i
jobbsökandet

2014-12

Përkrahje dhe bashkërendim – përkrahje më e madhe në kërkim të punës

Përkrahje dhe bashkërendim është një shërbim për ty që ke nevojë për një përkrahje intensive në të kërkuarit e punës. Shërbim jepet nga lëvrues privat që kanë kontratë me Zyrën e Punësimit ku ty të jepet ndihmë e thukt për në rrugën e punësimit. Përkrahja mund të jetë në formë të mjeteve në të kërkuarit e punë si dhe ndihmë në krijimin e lidhjeve me punëdhënës. Ti vet e zgjedh se cilin lëvrues don ta përdorësh për këtë shërbim. Qëllimi i masës Përkrahje dhe bashkërendim është që ti sa më parë të punësohesh apo të fillosh ndonjë shkollë.

Parakushtet dhe nevojat tuaja vendosin

Asistenti i zyrës së punësimit e bën vlerësimin nëse ti mund t'a shfrytëzosh Përkrahje dhe bashkërendim dhe nivelin e ndihmës që do ta marrësh. Ky shërbim i ka katër nivele të ndryshme:

Përkrahje dhe bashkërendim (koordinim) themelor

Ndihmë për të përmirësuar të kërkuarit e punës, koordinim me vende të lira pune si dhe krijimi i kontakteve me punëdhënës dhe rrjeteve shoqërore.

Blloku 1: Sëpaku 30 minuta bisedë individuale dhe katër orë aktivitete në javë. (3 muaj)

Blloku 2: Sëpaku 30 minuta bisedë individuale dhe nëntë orë aktivitete në javë. (3 muaj)

Përkrahje dhe bashkërendim (koordinim) themelor me ndihmë në gjuhë

E njëjta ndihmë sikur Përkrahje dhe bashkërendim themelor por ti merrë pjesë në gjuhën tuaj amtare, në ndonjë gjuhë tjetër që ti e flet mirë apo me ndihmë të një përkthyesi.

Blloku 1: Sëpaku 45 minuta bisedë individuale dhe katër orë aktivitete në javë. (3 muaj)

Blloku 2: Sëpaku 45 minuta bisedë individuale dhe nëntë orë aktivitete tjera në javë. (3 muaj)

Përkrahje dhe bashkërendim (koordinim) i përforcuar

Më shumë kohë tek lëvruesi sesa në nivelin themelor

Blloku 1: Sëpaku 30 minuta bisedë individuale dhe tetë orë aktivitete në javë. (3 muaj)

Blloku 2: Sëpaku 30 minuta bisedë individuale dhe dymbëdhjetë orë aktivitete në javë. (3 muaj)

Blloku 3: Sëpaku 30 minuta bisedë individuale dhe 20 orë aktivitete tjera në javë. Përfshirë edhe praktikën(3 muaj)

Përkrahje dhe bashkërendim (koordinim) i përforcuar me ndihmë në gjuhë

Më shumë kohë tek lëvruesi. Ti merrë pjesë në gjuhën tuaj amtare, në ndonjë gjuhë tjetër që ti e flet mirë apo me ndihmë të një përkthyesi.

Blloku 1: Sëpaku 45 minuta bisedë individuale dhe tetë orë aktivitete tjera në javë. (3 muaj)

Blloku 2: Sëpaku 45 minuta bisedë individuale dhe dymbëdhjetë orë aktivitete në javë. (3 muaj)

Blloku 3: Sëpaku 45 minuta bisedë individuale dhe 20 orë aktivitete tjera në javë. Përfshirë edhe praktikën. (3 muaj)

Përmbajtja i përshtatet asaj që ti dhe lëvruesi konsideroni se ke nevojë për të mësuar sesi kërkohet punë. Ti merr pjesë në Përkrahje dhe bashkërendim tre muaj, pastaj e bëjmë vlerësimin e të arriturave. Ne mund ta vazhdojmë shërbimin me tre muaj e në disa raste edhe me tre muaj të tjerë. Më së gjati mund të marrësh pjesë nëntë muaj në shërbimin Përkrahje dhe bashkërendim.

Këtë mund të marrësh në këtë shërbim

Parakushtet dhe nevojat tuaja diktojnë se çfarë përmbajtje do të ketë ky shërbim. Disa shembuj janë: Ndihmë për të gjetur dhe kërkuar punë, ndihmë për të krijuar dokumente për aplikim, kontakte me punëdhënës, biseda për rritjen e motivacionit, këshillim rreth studimeve dhe zgjedhjes së profesionit, vizita studimore, aktivitete me praktikë në vende pune, mësim gjuhe etj.

Ti e zgjedh lëvruesin

Ti vet e zgjedh lëvruesin se ku do të shkosh, në arbetsformedlingen.se, nën titullin *Stöd och service*, gjenë informacione për të gjithë lëvruesit dhe udhëzime sesi kërkon. Shiko p.sh. metodikën e lëvruesit, gjuhën, dituritë e lëmisë së caktuar apo ndonjë specializim tjetër, para se të bësh zgjedhjen tuaj. Ti mun të kërkoksh lëvrues edhe në bazë të qytetit tuaj. Lajmëroje pastaj asistentin tuaj në zyrën e punësimit se cilin lëvrues e ke zgjedhur.

Kështu funksionon

1. Asistenti i zyrës së punësimit vendos që të miratohet shërbimi Përkrahje dhe bashkërendim dhe vlerëson se cili nivel i ndihmës të përshtatet më së miri.
2. Ti e zgjedh lëvruesin dhe e njofton asistentin e zyrës së punësimit.
3. Lëvruesi të kontakton ty për një takim të parë. Është një bisedë fillestare ku ju e bëni një plan sesi të gjesh një punë sa më shpejt.
4. Gjatë kohës që merr pjesë në Përkrahje dhe bashkërendim duhet të vazhdosh zbatimin e planit që ke me zyrën e punësimit dhe kërkon punë dhe bëne raportimin e aktiviteteve si zakonisht.
5. Pas tre muajsh asistenti i ytë dhe ti i shikoni të arriturat dhe vendosni nëse ke nevojë edhe për tre muaj tjerë të shërbimit Përkrahje dhe bashkërendim.

Mundësi për të ndërruar lëvrues

Nëse të duket se përkrahja që të jepet nuk u përgjigjet nevojave tuaja ti ke mundësi të ndërrosh lëvrues. Kontaktoje asistentin tuaj për ndihmë të ndërrimit. Ti i ke 14 ditë kohë ç'lajmërimi, që do të thotë se gjatë kësaj kohe duhet të shkosh tek lëvruesi i vjetër. Tek lëvruesi i ri e vazhdon shërbimin aty ku ke mbetur, pra nuk ia fillon një periudhe të re tremujore.

Mendo që gjithmonë të na kontaktosh nëse ke ndonjë ankesë ndaj lëvruesit tuaj.

Na telefono në 0771-416 416 nëse je i interesuar të dish më shumë. Ti mund ta vizitosh edhe zyrën më të afërme të punësimit ose viziti uebsajtin arbetsformedlingen.se.